



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Në çështjen juridike të:

AC-I-16-0043

Ankuesja/ e paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. Agim Ramdani, 23. Prishtinë

Kundër:

Paditësi

Xh.D. Vushtrri, përfaqësuar nga avokati.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami Gjyqtar Kryesues, Sabri Halili dhe Mr. sc. Sahit Sylejmani, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjyqtarit të vetëm me kompetenca të deleguara të Kolegjit të Specializuar, C-IV-13-0060 të datës 19/02/2016 në seancën vendimmarrëse të mbajtur më 19 shtator 2019, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

1. Ankesa e të paditurës është e bazuar.

- 2. Ndryshohet, Aktgjykimi i Gjyqtarit të vetëm me kompetenca të deleguara të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, C-IV-13-0060 të datës 19/02/2016.**
- 3. Vërtetohet, Vendimi i AKP-së, Autoritetit të Likuidimit nr. MIT027-0191 të datës 11 shkurt 2013.**
- 4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat Faktike dhe Procedurale.

Me datë 28 shkurt 2013, paditësi ish punëtor i NSH-së "L" nga Vushtrria, i përfaqësuar nga Avokati, ka paraqitur ankesë në DHPGJS kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr. MIT027-0191 të datës 11 shkurt 2013, me të cilën ishte refuzuar kërkesa e tij për shpërblimi për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punësimit, në shumë prej 1.180,00 nga NSH –"L" Vushtrri (në Likuidim). Ankesës i ka bashkangjitur Vendimin e Autoritetit të likuidimit si dhe Njoftimin e AKP-së për ndërprerjen e marrëdhënies së punës .

Në përgjigje ndaj ankesës AKP-ja pohon se ankuesi ka filluar punën në NC andaj ankesa e tij duhet të refuzohet si e pa bazuar.

Me datë 19 shkurt 2016, Gjyqtari i vetëm me kompetenca të deleguara i Kolegjit të Specializuar i DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-13-0060, e aprovon ankesën e paditësit si të bazuar, shfuqizon Vendimin e të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr. MIT027-0191 të datës 11 shkurt 2013, dhe obligon të paditurën që ankuesit ,Xh.D. ti paguajë shumën prej 1.180,00 euro në emër të dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës me arsyetim se provat e parashtruara, Njoftimi i AKP-së për ndërprerjen e marrëdhënies së punës qartazi tregojnë se të njëjtit me 22 korrik 2005 ankuesit i ishte ndërprerë, marrëdhënia e punës.

Më 10/03/2016, AKP-ja parashtroi ankesë kundër Aktgjykimit C-IV-13-0060 të datës 19 shkurt 2016 (me tutje Aktgjykimi i ankimuar) . Nëpërmjet ankesës, AKP-ja kërkoi nga Kolegji i Apelit që të shfuqizoj, Aktgjykimin e ankimuar dhe të vërtetoj Vendimin e Autoritetit të likuidimit me arsyetim se ankuesi ka krijuar

marrëdhënie të re pune me " N C L" . Një marrëdhënie të tillë sipas AKP-së, ankuesi nuk e ka kundërshtuar asnjëherë. Gjithashtu AKP-ja pohoi se është e paqartë se si ankuesi ka arritur deri te shuma prej 1.180,00 euro. Ankesës i bashkëngjiti edhe Kontratën fillestare të punës me " N L" si dhe Kontratën vijuese si dhe listën e punëtorëve që kanë kaluar nga NSH-sh në N Co.

Ankesa i është dërguar përfaqësuesit të paditësit më 15/08/2016. Deri më tani nuk është parashtruar përgjigje.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa është e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr.06/L-086 për DHPGJS, Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Aktgjykimi i ankimuar nuk është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor , andaj duhet të anulohet.

Me Vendimin e AKP-së, është vërtetuar se paditësi ishte i punësuar në Ndërmarrjen e Re, në përputhje të plotë me Marrëveshjen për Zotime. Prandaj, në vend se të bëhet tepricë pas privatizimit, paditësi vazhdoi marrëdhënien e tij të punësimit me Ndërmarrjen e Re, e privatizuar me spin off-it special .

Në rastin konkret, gjyqtari i vetëm me kompetenca të deleguara i Kolegjit të Specializuar është bazuar vetëm në njoftimin të cilin AKM-ja me datë 22 korrik 2005, të cilin AKM-ja ia kishte dërguar paditësit. Në bazë të këtij njoftimi paditësi i është ndërprerë marrëdhënia e punës në NSH me datë 22 korrik 2005, në ditën kur Bordi i AKM-së e ka aprovuar kontratën e shitjes së NSH-së.

E paditura në ankesë ka pretenduar se ankuesi menjëherë pas datës së privatizimit të NSH-së ka vazhduar punësimin në Ndërmarrjen e Re, dhe ky pretendim i saj me asnjë provë nuk ka mundur të kundërshtohet nga paditësi. Paditësi për këtë fakt të pohuar nga AKP-ja fare nuk është përpjekur të sjellë ndonjë dëshmi për ta rrëzuar

atë fakt. Madje paditësi vetëm ka pohuar se marrëveshja për zotime është fiktive pa ofruar asnjë provë relevante .

Andaj nga këto arsye, nuk është i saktë rezultati i dhënë me Aktgjykimin e ankimuar, pasi që pretendimi i AKP-së për vazhdimin e punësimit të ankuesit në Ndërmarrjen e re ishte një fakt i vërtetuar.

E paditura në procedurën ankimore bashkë me ankesë, ka dërguar edhe disa kopje të kontratave të punës të cilat paditësi i ka lidh me NC L L.L.C në Vushtrri me numër të biznesit si dhe një listë të punësuarve në " NC L" Vushtrri në të cilën listë punëtori Xh.D. renditet në nr. rendor 251.

Kolegji i Apelit ka vërejtur se në bazë të nenit 1 të Kontratës së punësimit nr. 46 të lëshuar me datë 18/0/01/2006, punëdhënësi i ofron punësimin paditësit prej datës 23.07.2005 e deri me 23 janar 2006, dhe ky punësim me Kontratën tjera që janë në dosje është vazhduar. Në bazë të kësaj dëshmie të cilën e ka sjellë AKP-ja me ankesën e saj, është e qartë se paditësi menjëherë ka vazhduar punësimin në Ndërmarrjen e re, ngase data e privatizimit të NSH-së ishte me 22 korrik 2005, ndërsa paditësi ka vazhduar punësimin me kontratën e cekur, prej datës 23 korrik 2005.

Rrjedhimisht mund të konstatohet se nuk ka pasur asnjë boshllëk kohor të ndërprerjes së punësimit të paditësit, andaj ai nuk ka pësuar dëmin e pretenduar për ndërprerjen e parakohshme të kontratës së punës. Një qëndrim të tillë në jurisprudencën e vet për të njëjtë NSH, Kolegji i Apelit e ka marrë edhe në rastin AC-I-14-0134.

Nga këto arsye, kërkesa e paditësit për kompensimin e dëmit për ndërprerje të parakohshme të kontratës, në bazë të nenit 40.1.6.2 të Ligjit të AKP-së, është e pabazuar.

Nga këto arsye, ankesa e të paditurës është aprovuar si e bazuar, është anuluar Aktgjykimi i ankimuar si i pasaktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, dhe është

vërtetuar vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Andaj, në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, Kolegji i Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksat gjyqësore

Nuk caktohen taksat gjyqësore për procedurë ankimore pasi që ankuesja e ka paguar taksën gjyqësore më 23/03/ 2016.

Vendosur nga Kolegji i Apelit i DHPGJS, më 19 shtator 2019.

Ilmi Bajrami, gjyqtari kryesues

URDHËR PËR ZYRËN E REGJISTRIMIT

Ju lutem dërgoni këtë Aktgjykim:

- Palëve,
- Gjyqtarit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS në rastin C-IV-13-0060

Ilmi Bajrami , Gjyqtar kryesues _____